

ERZEN KOPERAJ

FORMAT E PASHTJELLUARA TË SHQIPES TEK AUTORËT E SHEKULLIT XVIII

Në shekujt e parë të periudhës shkrimore të shqipes, format e pashtjelluara paraqesin disa zhvillime. Pjesorja, si e vetmja formë e pashtjelluar sintetike dhe më e konsoliduara, krijon disa prapashtesa të përbëra, ndërsa për disa forma të pashtjelluara analitike, jo me bazë pjesoren, por emrin prejpjesor asnjans, të tipit për të bërë dhe me të bërë formohen dhe kristalizohen si të tilla. Në këtë kumtesë jemi përqendruar tek disa veçori të këtyre formave të pashtjelluara tek disa autorë gegë të shek. XVIII.

Pse autorët gegë, pasi në shekullin XVIII, kemi J. Varibobën, me *Gjella e shën mërisë virgjër*, *Protopirinë* e Kavalitit, dorëshkrimet e K. Berati-t, M. Zades e të tjerë autorëve toskë? Arsyeja qëndron se, ndryshe nga toskërishtja që paraqitet homogjene në formantet e pjesores dhe formave të tjera, të pashtjelluara në përgjithësi, gegërishtja paraqet një sërë zhvillimesh. Ndërsa jemi përqendruar në shkrimet e shqipes së shekullit XVIII, pasi në këtë periudhë kemi shfaqjen e disa prapashtesave të përbëra tek pjesorja si dhe për disa elemente që lidhen me format e pashtjelluara analitike. Padyshim që shqipja e kësaj periudhe paraqitet si një zhvillim i ndërmjetëm mes asaj që njohim si shqipja e autorëve të vjetër, nga Buzuku tek Bogdani, pra që përfshin shek. XVI-XVII, dhe shqipen e Rilindjes. Bëhet fjalë për atë periudhë që studiuesit të cilët janë marrë me periodizimin e shqipes, e cilësojnë si pragun e shqipes së sotme. Në shekullin e tetëmbëdhjetë për herë të parë na dëshmojnë të gjitha formantet e pjesores që njeh shqipja, përveç atyre me *-m*, *-në*, *-të*, *-un*, që gjejmë tek autorët e vjetër, po ashtu për herë të parë na dalin pjesoret me prapashtesat e përbëra *-nun* dhe *-mun*.

Prapashtesa *-nun* është një prej formanteve që dalin në kapërcyellin e shekujve XVII-XVIII. Kjo prapashtesë e përbërë nga bashkimi i prapashtesës *-n^dë* me prapashtesën *-un(ë)*. Si formim paraqitet relativisht i vonë, por edhe me një përdorim të kufizuar. Te Buzuku, Budi dhe Bardhi nuk e ndeshim një prapashtesë të tillë. Për herë të parë e ndeshim te Bogdani: *dhanunë* (ÇP, XV. 22), *kjanunë* (ÇP, XVIII. 13), më pas te da Lecce ndeshet vetëm tek folja *njanunë* (*unirsi*, Fj.) dhe tek Gj. N. Kazazi, *ngranun* / *ngrenun* (Doct. 26), *lanun* (Doct. 12). Kjo pjesore ndeshet më shumë tek autorët gegë të mesit të shekullit XIX, por gjithnjë me përdorime të kufizuara¹. Diçka të ngjashme e

¹ E. Radoja, "Jezu Criscti / n' zemer t' mesctaarit / kuitime t' scpirtit / ci do t' keet mesctaari per githzilen dit t' moit / kthye schiyp' prei / d. Èignl Radojet / prift' i dieces' Scodrs / n' Rom / me sctamp t' Cuvenit Scët t' Propagands", Romë 1862. Gjejmë format *lanun*, f. 6,

gjejmë edhe tek Epika Legjendare, ku forma të tilla janë kryesisht dublete, si variante të pjesoreve të pazgjeruara me to. Madje duket se më shumë ndikon rrokjezimi i vargut sesa përdorimi i lirë i tyre². Kjo prapashtesë e përbërë duhet të ketë ardhur nga perceptimi që i është bërë pjesoreve me -në, si *thanë*, *ngranë*, *zanë*, etj. prapashtesë kjo e parotacizuar edhe në toskërishte, si pjesore me temë në bashkëtingëllore.

Prapashtesën -*mun* nuk e ndeshim tek autorët e gegërishtes të shekujve XVI-XVII, dokumentohet në gjysmën e dytë të shekullit XVIII. Për herë të parë del tek dorëshkrimet e Th. Haxhifilipit, në trajtat *mallënjy-mun*, *qirumun*, *shenjëtenu-mun*, *kthye-mun*...a të lusim Zotin qi të keet me i *mallëngjymun* Zoti, të keetë me ju dhidhaksun fjalënë e së vërtetës³. Por kjo prapashtesë bëhet më e pranishme dhe më e përhapur në fillimet e shekullit XIX. Mjaft të përdorur e gjejmë te një fjalor shqip-turqisht (1835)⁴, mbështetur në të folmen e qytetit të Shkodrës. Aty gjejmë pjesore të tilla si *damun*, *hi-mun*, *qa-mun*, *xi-mun*, por nga ana tjetër pjesa më e madhe e pjesoreve në tog zanor dalin pa prapashtesë, si: *çue*, *shkue*, *plehnue*, etj. Por nga ana tjetër në *Vehbijen* e T. E. Boshnjakut (1835)⁵, që i takon të folmeve të Gjakovës, mjaft e afërt me atë të Shkodrës, nuk kemi asnjë rast pjesoreje të tillë, por mbizotërojnë vetëm ato pa prapashtesa. Prapashtesa -*mun* shfaqet shumë rrallë dhe tek shkrimtarët gegë të pak dekadave më vonë, të mesit të shek. XIX (E. Radoja, K. Kristoforidhi, P. Babi, etj.), *pa-mun*, *ba-mun*. E. Radoja si “Concili i Өeut Scçiöpnis”, Romë 1872, f. 56.19; te Kristoforidhi e përdor këtë prapashtesë në botimin e tij të parë: Katër ungjillat / e zotit edhe shëlbusit tonë / Jesu Krishtit, / edhe / punët e apostuivët / **këthymun** prei Greqishtes vietër / shqip / ndë gjuhë gegënishte / prei Konstantinit Kristoforidit, Elbasanasit / Konstantinopol 1866, ndërsa në botimin e dy viteve më vonë përdor formën e pjesores vetëm me prapashtesën -m: Dhiata e re / e Zotit edhe shëlbyesit t’ynë / Iesu Krishtit, / **këthyem** prei greqishtesë vietër /

thanun, f. 14, *ngranun*, f. 23; tek vepra e Francavilla Bonaventura, “N’laud tinzot / e n ndëeren e zojës beekúeme / edhe per / scëlbim scpirtnavet kioft / *zanun* fill, edhe marue / ket letrr rfëmit / prei p. b. d. f. m. os. / se Provinces Scëit Bernardini / n’ Rom”. Romë, 1863.

² “Ç’ka ka qitë burri me ‘i herë e i ka *thanun*..”, Visaret e kombit, v.II, botime françeskane, Shkodër, 2005, shtojca. f. 22.19, por edhe “...nana e vet djalit çka i ka *thanë*..”, f. 207. 15.

³ Shembujt janë nxjerrë nga tekstet e A. Haxhi, T. Topalli, *Historia e gjuhës së shkruar shqipe*, Shkodër, 1999, f. 131, Dh. Shuteriqi, Dhaskal Todhri, *Nëpër shekuj letrarë*, Tiranë, 1973, f. 98-106, M. Hysa, *Autorë dhe tekste nga letërsia e vjetër shqipe*, II, Shkup, 1995, f. 92.

⁴ O. Myderrizi, *Një fjalor i vjetër shqip-turqisht*, në BISSH, Tiranë, 1951, nr. 1, f. 82-85, si dhe Jup Kastrati, *Historia e Albanologjisë*, Tiranë, 2000, f. 525.

⁵ Teksti i dorëshkrimit jepet në veprën e Idriz Ajetit, në Studime dialektore dhe etimologjike, Tiranë, 2005, f. 217-302.

shqip / ndë Gjuhë gegënishte / prei / Konstantin Kristoforidit, Elbasanasit. / Konstantinopol. 1869. Ndërkohë që e gjejmë tek gramatika e A. Xanonit, ku ndryshe nga prapashtesa *-m*, prapashtesa e përbërë *-mun*, monoftongon togun zanor të temës së foljes, *fillue-m ~ fillu-mun; nje-m ~ nje-mun*, etj.⁶, tek ajo e A. Xhuvanit, *la-mun, ble-mun*⁷, por edhe tek I. D. Sheperi, *la-mun*⁸. Duket qartë që përdorimi i saj është i kufizuar. Siç shihet, kjo prapashtesë nuk duhet të jetë e vjetër, edhe sot ajo del vetëm në disa të folme periferike të gegërishtes⁹. Por edhe tek Eposi i kreshnikëve pjesoret me këtë formant nuk dalin relativisht dendur “coftë në tokë qet me ‘i herë kan *ramun*...se un ma t’mirë kam me i *blemun*”, Visaret e kombit, v. II, shtojca. f. 22.5 / 22.16, “...njaty m’i ka *premun*...udhëtare janë *bamun*”, f. 41.7/41. 34, “...kanë kaluemun tri dit e tri net..”, f. 21.40., kjo mund të ketë ardhur edhe si rezultat i krijimit artistik në vargje (ndoshta për hir të ruajtjes së numrit të rrokjeve).

Mendimet për prejardhjen e saj janë të ndryshme. Jokli shihte te kjo formë vazhdimin e trajtës së rasës kallëzore të prapashtesës indoevropiane *-meno-s*, kurse tek *-m* ai shihte vazhdimin e përdorimit të trajtës së rasës emërore¹⁰. Një mendim i tillë nuk ka gjetur mbështetje. Prapashtesa *-mun* duhet të jetë përftuar nga bashkimi i dy prapashtesave, përkatësisht *-m* dhe *-un*, duke i dhënë karakter ridondant. Sh. Demiraj dhe K. Topalli e gjykojnë si një shfaqje mbikarakterizimi gramatikor¹¹. Perceptimi i pjesoreve të krijuara me prapashtesën *-m* (*da-m, punue-m*), si folje me temë në bashkëtingëllore, ka bërë, që për analogji, t’i prapangjitet edhe prapashtesa tjetër trajtëformuese e pjesores *-un*, duke dhënë edhe pjesoret *da-mun, punu(e)-mun* etj. Përsa i përket shtrirjes gjeografike, duke iu referuar dokumenteve shkrimorë të kësaj periudhe, mund të gjykohet për një përhapje të kufizuar, kryesisht në qytetet e Shqipërisë së Mesme, Elbasan, Tiranë (sipas Atl. Dialekt. gjendet edhe sot e përdorur në këto zona¹²), por edhe në Shkodër e Prizren. Megjithatë nga dokumentimi shkrimor në kapërcyellin e shek. XVIII-XIX, nuk mund të ndërtohet një hartë të tillë. Në përhapjen e kësaj prapashtese mund të ketë pasur ndikim edhe letërsia e bejtexhinjve tek të cilët ndeshet më shpesh trajtat e pjesores me këtë prapashtesë të përbërë S. Riza, *Tri monografina albanologjike*, në Vepra të zgjedhura, Tiranë 2009, f. 127 “...kjo formë

⁶ A. Xanoni, *Gramatika shqyp*, Shkodër, 1909, f. 108.

⁷ A. Xhuvani, *Libri i gjuhës shqipe*, 1921, f. 86.

⁸ I. D. Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe, sidomos e toskërishtes*, Vlorë, 1927, f. 95.

⁹ Shih, *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, V. I, harta nr. 86.

¹⁰ N. Jokl, IF 36, 122, citim i marrë nga Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë 1986, f. 945.

¹¹ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë 1986, f. 945 dhe K. Topalli, *Sistemi foljor i shqipes*, Tiranë, 2010, f. 470.

¹² *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, Vëll. I, Napoli, 2008, harta nr. 80.

verbale, në fillim të fillimit, do të ketë qenë vetëm e vetëm ...bejtaxhore, tue pasë nevojë për një rrokje më shumë...”. Megjithatë ka shumë mundësi të jetë përhapur nga e folmja që paraqesin dorëshkrimet e Th. Haxhifilipit, tek i cili gjejmë për herë të parë të dokumentuar këtë prapashtesë të përbërë. Duke ditur edhe ndikimin e madh që pati ky autor dhe alfabeti i tij nga Elbasani në Berat dhe Durrës¹³, si dhe duke iu referuar edhe shtrirjes dialektore të përdorimit të saj, ku shihet përqendrimi në të folmet e gegërishtes jugore, kjo duhet të ketë qenë zona e parë e përhapjes edhe në të folme të tjera të gegërishtes.

Në lidhje me përdorimin e këtyre prapashtesave të përbëra mendoj se nuk duhen gjykuar as si ndikim nga krijimet epike, apo nga ato të bejtexhinjve për të plotësuar rrokje e vargut. Unë e gjykoj si një tendencë të gegërishtes për një unifikim të prapashtesave të pjesores, dhe duke unifikuar edhe temën e pjesores me mbiemrin, në kuptimin jo më *i lam e lame*, por *i lamun e lamun*; si në toskërishte *i larë*; *e larë* ku diferencën mes pjesores dhe mbiemrit e luan vetëm nyja e përparme.

Mbështetem në këtë pikë edhe për arsyen se është periudha kur në territoret shqiptare kemi një frymë të tillë të forcimit të identitetit gjuhësor si identitetit kombëtar. Duke filluar me etnonimin shqiptar që fillon e del tek Kuvendi i Arbënit dhe Da Lecce, apo dhe ngjarjeve historike që zunë fill në këtë shekull, për të kulmuar më pas me Rilindjen Kombëtare. Në shkrimet shqipe të shekullit XVIII, bie në sy përdorimi i formave të pazgjeruara të pjesores, pa prapashtesa. Kështu, tek Dokumentet e Kuvendit të Arbënit, kemi disa raste të përdorimit të pjesoreve pa prapashtesa: nevoeja *lyp* kishte via ma të mira..(f. 8.13), ...ende Provincia e Durcit *desherie* kisht mbe nierëzit kishtare..(f. 107.8) ...tue kienë ligjat e Romësë të dëlira, të shëndosha, paa *lye*... (f. 42.3), ...këta po duenë me *shtii* nde dheetë... (f. 81.2), ndërsa te Anonimi i Elbasanit kemi *psua* (f. 4). Ndërsa në shkrimet geqe të fillim shekullit XIX, kjo formë e pjesores bëhet më e ndeshura, p.sh. te P. Zarishi në Krijimi i rruzullimit (1823), *gzue* (terc. II); *gjimue*, *premtue* (terc. III), *pshty* (terc. IV) etj.; Z. Bastari (fillimi i shek. XIX): *mluu*, *bâ*, *lee*, etj.¹⁴; T. E. Boshnjaku (1825): *vluue*, *sharrue*, *bâ*, *pâ*, *shti*, *raa*, etj.¹⁵; Luca da Monte Giove (1848) *shkurtue*, *harrue*, *zotnue*, *lijue* etj.¹⁶; E. Radoja (1862): *nkthye*, *bâa*,

¹³ A. Haxhi, T. Topalli, *Historia e gjuhës së shkruar shqipe*, Shkodër, 1999, f. 131, Dh. Shuteriqi, *Dhaskal Todhri*, Nëpër shekuj letrarë, Tiranë, 1973, f. 98-106.

¹⁴ A. Haxhi- T. Topalli, *Historia e gjuhës së shkruar shqipe*, Shkodër, 1999, f. 138.

¹⁵ Idriz Ajeti, *Studime dialektore dhe etimologjike*, Tiranë, 2005, f. 217-302.

¹⁶ Në fjalorin e tij (dorëshkrim) të 1848, misionari katolik italian që shërbeu për 20 vite në zonën e Pultit jep të dy format edhe atë me prapashtesat e pjesores, ashtu dhe formën e pazgjeruar, abilitare – me *ëotnue* (f. 3/23), por edhe *zotnuem* (f. 3/21), apo *me harru* dhe *harruem* etj.

shkrue, vîu, pëlqye etj.¹⁷, si dhe tek *Eposi i Kreshnikëve* ku pothuaj pjesoret pa prapashtesë tek foljet me temë në zanore janë kthyer në sistem¹⁸.

Mendoj se është e vështirë që këto forma pjesore të jenë shfaqur papritmas si rezultat i një asimilimi prapavajtës i prapashtesave pjesoreformuese në gegërishten e shekullit XVIII-XIX. Përdorimi i pjesoreve pa prapashtesë duhet të ketë qenë mjaft frekuent në gegërishte edhe në periudhën e shekujve XVI-XVII, por mendoj se autorët tanë mund t'i kenë gjykuar si variante të shkurtuara të pjesores dhe kjo i ka shtyrë përgjithësisht t'i plotësojnë me prapashtesa në rrugë analogjike me prapashtesat e mirëfillta të pjesores (duke u bazuar tek tingujt fundorë të temës së foljes). Përndryshe nuk ka sesi të kuptohet prania e këtyre pjesoreve pa prapashtesë tek dorëshkrimi gjuhësor i manastirit të Grotaferratës, me *shtrënge*, me *mjeku*, me *kendue*, me *shtrue*, etj.¹⁹, ndërkohë që krahas këtyre formave ndeshim edhe *me kaluem*, *me lyem*, *me vraam*, *me shiim*, etj. Por edhe tek këlmendasit e Sirminies, në një material gjuhësor të mbledhur nga një studiues hungarez, më 1777, gjejmë pjesore *lmua*, *martua* (me u martua), përkrah pjesoreve me *-m*, *shtrua-m*, *vorrue-m*²⁰.

Mendojmë se këto trajta nuk duhet të kenë ardhur si pasojë e një reduktimi të formave të pjesores, përkundrazi, ato duhet të kenë ardhur në sistemin e pjesoreve nga një formë tjetër e pashtjelluar, sepse vështirë që forma themelore e foljes të ketë kuptimin kohor të së shkuarës, që ka pjesorja e shqipes²¹. Mbase, kjo formë e pjesores pa mbaresë mund të ketë një origjinë paskajoreje që me kalimin e kohës është perceptuar si pjesore për shkak të formës analitike që mori paskajorja në gegërishte dhe format e tjera analitike që njih sot shqipja.

Por duke mbetur tek zhvillimi i formave të pashtjelluara, tek pjesorja, krahasuar me autorët e shek. XVI-XVII, ajo çfarë bie në sy është dhe rrudhja e përdorimeve sintaksore të pjesores. Përgjithësisht, shihet varfërimi i përdorimit të pjesores si përcaktor dhe si përcaktor kallëzuesor. Po të shihet përdorimi i pjesores nga Kuvendi i Arbënit 1703 e deri tek Gj. N. Kazazi, shohim një varfërim të përdorimit sintaksor, si dhe tek autorët e gegërishtes

¹⁷ Tek E. Radoja, në ripërkthimin e tij të dokumenteve të Kuvendit të Arbërit (botuar më 1872), përdor përgjithësisht format e pazgjeruara, aq sa do ta quaja të parën vepër në gegërishte ku mbizotërojnë pjesoret pa prapashtesa.

¹⁸ "...at be m' Zotin djali ka *bâ* / ...dheu m'ka *mlue* e fat s'i qita vedit / ...tridhetë vasha t'i kanë *prû*.", në Visaret e Kombit, Epika legjendare, v. II, Tiranë, Nikaj, 1937, f. 27.3 / 27.9 / 27.38.

¹⁹ A. Landi, *Fjalori italisht-shqip sipas alfabetit të Badias greke të Grotaferratës*, Salerno, 1988, f. 14, cituar sipas J. Kastratit, *Albanologjia*, Tiranë, 2000, f. 257.

²⁰ Lidhur me këtë shih, Dh. Shuteriqi, *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800*, Tiranë, 2005, f. 317, si dhe Albania, 1902, f. 50.

²¹ K. Topalli, *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2010, f. 470.

jugore një rrudhje e përdorimit të asnjansit duke çuar në kristalizimin e formave të pashtjelluara analitike më të reja, kryesisht ato me kuptim paskajor dhe gerundival (si *për të bërë, me të bërë*, apo dhe *së bëri*), të cilat shfaqen të zhvilluara në periudhën e dokumentuar të shqipes.